




AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 03-02/4023/17
Nr. llog. Broj stranica 02	Data Datum 07-12-2017
P. SHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.12.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-3514/17 për z. Safet Voca – Anëtar i Komisionit për ndihmë juridike falas, për shkak se ai këtë funksion e ushtron sipas detyrës zyrtare, i propozuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur, me nr. protokoli AKK-03-02-3514/17 për Zyrtarin e lartë, z. Safet Voca – Anëtar i Komisionit për ndihmë juridike falas, ka qenë një situatë e dyshuar me konflikt interesi për shkak se gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik zyrtarët e lartë nuk kanë të drejtë që njëkohësisht të ushtrojnë edhe veprimtari private të avokatisë, noterisë, ekspert i licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave fitimprurëse dhe jo fitimprurëse (Neni 16, paragrafi 2, i Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, Nr. 04/L-051).

Agjencia kundër Korrupsionit e ka hap si rast të dyshuar, por gjatë procesit të hetimit është konstatuar se z. Voca funksionin e tij si Anëtar i Komisionit për ndihmë juridike falas e ushtron sipas detyrës zyrtare (ex Officio), i propozuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, në vështrim të nenit 11, të Ligjit për ndihmë juridike falas, e pastaj i votuar nga Kuvendi i Kosovës në seancë plenare të mbajtur me 30 nëntor 2015 (DPK-03-02-3955).

Në rastet kur zyrtari i lartë publik ushtron një funksion që i dedikohet për shkak të funksionit (Neni 16, paragrafi 1, i Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik), kjo situatë nuk paraqet konflikt interesi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Shaip Havolli /

